



## **SYLLABUS I LËNDËS: LETËRSI ANTIKE**

<b>Të dhëna bazike të lëndës:</b>	
<b>Universiteti:</b>	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Filologjisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Letërsi antike</b>
<b>Programi:</b>	Gjuhë dhe letërsi shqipe
<b>Niveli:</b>	Baçellor
<b>Statusi lëndës:</b>	Zgjedhore (Z)
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti I, Semestri II
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 +1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	3
<b>Koha / lokacioni:</b>	Semestri veror
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. ass. dr. Manjola Brahaj Halili</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:manjola.brahaj@uni-prizren.com">manjola.brahaj@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Programi i kësaj lënde parasheh paraqitjen kronologjike të lindjes dhe zhvillimit në kohë të letërsisë antike greke dhe romake me të gjitha gjinitë dhe llojet letrare që janë shkruar në atë periudhë të letërsisë. Në programin e kësaj lënde do të trajtohen çështje që lidhen me origjinën e kësaj letërsie, lidhjen e saj me mitologjinë, ndikimin e saj në shoqërinë dhe kulturën e kohës, si dhe ndikimin dhe rëndësinë e saj për letërsinë botërore të të gjitha kohërave. Gjithashtu programi do të përmbajë informacione, të dhëna dhe analiza për autorët më emblematikë dhe veprat më të rëndësishme të kësaj periudhe, duke nxjerrur në pah karakteristikat, vlerat dhe rëndësinë e saj në raport me periudhat e tjera të letërsisë.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi i programit të kësaj lënde është që të t'i njohë studentët me rrethanat historike, politike e shoqërore në të cilat u zhvillua letërsia antike. T'u japë atyre informacionin e duhur për autorët dhe veprat më të rëndësishme të kësaj periudhe. Si dhe t'i njohë ata me rolin dhe rëndësinë që ka patur drama, komedia dhe tragjedia në zhvillimin e shoqërisë së atërkohë, por edhe për zhvillimin e letërsisë botërore në përgjithësi.</p> <p>Gjithashtu ky program ka për syrim që t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi për interpretimin e llojeve të ndryshme të poezisë lirike, si dhe rolin dhe rëndësinë e tyre që kanë patur dhe kanë në zhvillimin dhe kuptimin e poezisë si lloj letrar në përgjithësi.</p>
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Gjatë dhe pas përfundimit të këtij kursi, studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• përshkruajnë kufijnjtë hapsinoro – kohor të shtrirje së letërsisë antike;</li><li>• shpjegojnë veçoritë dalluese të gjinive letrare që u zhvilluan në këtë periudhë;</li><li>• klasifikojnë autorë dhe vepra të ndryshme duke u bazuar në rolin dhe vlerat artistike të tyre;</li></ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjykojnë për rolin dhe ndikimin që veprat e antikitetit kanë sot në zhvillimin e letërsisë;</li> <li>• interpretojnë për çështje të letërsisë së kësaj periudhe me anë të teksteve të ndryshme vlerësuese.</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Kollokfiume, seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
<b>Totali</b>			<b>75 orë (3 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve, debateve dhe seminareve me metodat bashkëkohore. Do përdoren edhe punë me grupe, punë dyshe, diskutime rreth teorive, analiza praktike tekstesh etj		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i studentëve bazohet në punën, aktivizimin, frekuentimin, kolekviumet dhe punimin e prezantuar në përmbyllje të semestrit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Testi i parë: 1 – 30%</li> <li>2. Testi i dytë: 1 – 30 %</li> <li>3. Prezantimet studentore – 20 %,</li> <li>4. Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 20%</li> <li>5. Totali: 100 %</li> </ol> <p>(Vlerësimi në pikë: 01-50= 5, 51-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10)</p>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<p>Muzafer Xhaxhiu: Letërsia antike greke, Shblu, Tiranë, 2004.</p> <p>Muzafer Xhaxhiu: Letërsia romake, Shblu, Tiranë, 2004.</p> <p>Wilmer Cave Wright: A Short History of Greek Literature, from Homer to Julian, American Book Company, Chicago, 1907.</p> <p>Charles Thomas Cruttwell: A History of Roman Literature, Black mask online, 2003.</p>		

<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Homer: “Iliada”, përkth. Gjon Shllaku. Onufri, Tiranë, 2006.</p> <p>Homer: “Odiseja”, Homer: përkth. Pashko Gjeçi. Onufri, Tiranë, 2006.</p> <p>Vepra e plotë Safos: përk. Ilia Ballauri. Uegen, Tiranë, 2008.</p> <p>Eskili: “Prometheu i lidhur”, përk. Sotir Papahristo. Almera, Tiranë, 2010.</p> <p>Eskili: “Orestia”, përkth. Ismail Kadare. Botues: Onufri, Tiranë, 2006.</p> <p>Sofokliu: “Antigona”, “Edipi Mbret” dhe “Edipi në kolonë”, Vepra e plotë, përkth. Gjon Shllaku. Faik Konica, Prishtinë, 1995.</p> <p>Euripidi: “Medea”, përkth. Sotir Papahristo, Almera, Tiranë, 2007.</p> <p>Aristofani: “Bretkosat”, përkth. Sotir Papahristo, Almera, Tiranë, 2007.</p> <p>Aristoteli: “Poetika”, përkth. Sotir Papahristo, Çabej, Tiranë 2006.</p> <p>Virgjili: “Eneida”, përkth. Henrik Lacaj, Botues: Buzuku, Prishtinë, 2006.</p>
---------------------------	--

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<b><i>Prezantim i përgjithshëm i lëndës studimore. Hyrje në letërsinë antike</i></b>	<i>Diskutime rreth përkufizimit dhe rolit të letërsisë antike</i>
<i>Java e dytë:</i>	<b><i>Periodizimi i letërsisë antike</i></b>	<i>Diskutime rreth çështjes së periodizimit dhe veprave të para në letërsi</i>
<i>Java e tretë:</i>	<b><i>Mitologjia dhe lidhja e letërsisë antike me të</i></b>	<i>Diskutime për dhe komente rreth lidhjes së mitologjisë dhe letërsisë antike</i>
<i>Java e katërt:</i>	<b><i>Iliada – tema e luftës. Analizë e ideve dhe realizimit artistik</i></b>	<i>Lexime dhe komentime të veprës “Iliada” të Homerit</i>
<i>Java e pestë:</i>	<b><i>“Odiseja” – tema e kthimit. Analizë e tematikës, rolit të mitologjisë dhe realizimit të kompozicionit</i></b>	<i>Lexime dhe komentime të veprës “Odisea” të Homerit</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<b><i>Poezia lirike. Diskurse poetike: Ditirambi, himni, odeja. Safo, Alkeu, Pindari.</i></b>	<i>Lexime, analiza dhe komente për poezinë lirike dhe llojet dhe përfaqësuesit e saj</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<b><i>Elegjia antike dhe llojet e tjera të lirikës</i></b>	<i>Lexime, diskutime dhe krahasime mes elegjisë antike dhe asaj të më vonshme</i>
<i>Java e tetë:</i>	<b><i>Testi i parë vlerësues</i></b>	<i>Përmbledhje e lëndës</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<b><i>Tragjedia greke, Eskili: “Prometheu i mbërther” dhe trilogjia “Orestia”</i></b>	<i>Lexime dhe analizë e veprës: “Prometheu i mbërther”</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<b><i>Sofokliu: “Antigona”, “Edipi mbret”, “Elektra”. Analizë ideo – artistike. Euripidi: “Medea”, “Andromaka” Analizë ideo – artistike</i></b>	<i>Analizë, komente dhe diskutime rreth veprave të Sofokliut</i>



<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b><i>Krijimi dhe zhvillimi i komedisë; Aristofani – “Bretkosat”-dokumenti i parë i kritikës</i></b>	<i>Lexime fragmentesh dhe komente rreth komedisë së Aristofanit dhe realizimit të humort në të</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b><i>Aristoteli – mendimi teorik mbi letërsinë</i></b>	<i>Diskutime rreth risive dhe çështjeve të rëndësishme teorike të veprës “Poetika” të Aristotelit</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<b><i>Një hyrje e shkurtër në letërsinë romake</i></b>	<i>Lexime, shembuj dhe krahasime midis letërsisë greke dhe asaj romake</i>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<b><i>Virgjili: Eneida – miti i themelimit të kombit</i></b>	<i>Komente fragmentesh dhe diskutime rreth veprës “Eneida” e Virgjilit</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b><i>Testi i dytë vlerësues</i></b>	<i>Diskutime dhe konsultime rreth rezultateve të arritura</i>
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<p>Nuk do të ketë kurrfarë tolerime për “huazim” nga interneti apo kudo tjetër. Punimet e njëjta apo të ngjajshme gjithashtu do të ndëshkohen. Rekomandohet që punimet që dorëzohen të jenë të shkruara me kompjuter.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Studentët duhet t’u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UPZ-së dhe rregulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati i UPZ-së dhe këshilli mësimesor.</li><li>• Pritet që secili student të vijë me kohë.</li><li>• Nga çdo student pritët që të marrë pjesë në çdo ligjeratë.</li><li>• Për shkak të natyrës dhe mënyrës së mësimit në këtë lëndë, ardhja në mësime dhe pjesëmarrja aktive në diskutim është me rëndësi të veçantë.</li></ul>		